



KONGRESI
RINOR
KOMBËTAR

FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG



Shkodër

PLANI LOKAL I VEPRIMIT PËR RININË 2020-2023

- Shkodër -

Planet
Lokale të
Veprimit

Jeta Qytetare Tënd





Jeta Qytetin Tënd

Përmbajtja

I. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA


1.1 Qëllimi.....	06
1.2 Metodologjia	07
1.3 Parimet Udhëheqëse	09

II. BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE 10

III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI 12

IV. ANALIZA SWOT 19

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI 20



PËR REALIZIMIN E KËTIJ PLANI LOKAL VEPRIMI PUNUAN:

Koordinator Lokal dhe Hartues:
Engjell Gjugja,

Koordinator, Qendra Rinore "Atelie", Shkodër.

Ekspert Lokal:
Shpresa Mirashi

Terre Des Hommes, Shkodër.

Zamira Halluni

Terre Des Hommes, Shkodër.

Xhoelda Shelqetja

World University Services, Shkodër.

Pikë kontakti Bashkia:

Bujar Bajraktari

Specialist i Qendrave Komunitare, Bashkia Shkodër.

Koordinimi në nivel kombëtar dhe asistimi në hartim:

Sekretariati i Kongresit Rinor Kombëtar:

Dafina Peci,

Drejtoreshë Ekzekutive.

Korrektim dhe Kurim:

Shila Parllaku,

Oficere Komunikimi

Falenderime

Plani Lokal i Veprimit për Rininë u bë i mundur falë mbështetjes së plotë të Fondacionit Friedrich Ebert, i cili mbështet zhvillimin e politikave rinore në nivel vendor dhe qendror, në bashkëpunim me Kongresin Rinor Kombëtar.

Puna e zhvilluar në nivel kombëtar për planet e veprimit 2020-2023 në 12 Bashki ka pasur synim nxitjen e dialogut të strukturuar rini-institucione, në bazë të një metodologjie dhe rrugëtimi të njehsuar, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat aktive të Kongresit Rinor Kombëtar dhe me gjerë, të rinj nga shkollat e mesme dhe universitetet, si dhe me mbështetjen e madhe dhe angazhimin sistematik të Bashkive.

Këto plane do shërbejnë si një bazë orientuese politikash dhe veprimtarie të dedikuar për sektorin e rinisë, në përputhje të plotë me perceptimet dhe vizionin që të rinjtë dhe institucionet kanë mbi perspektivën lokale.

Një falenderim shkon për të gjithë ata që u bënë pjesë dhe kontribut në këtë rrugëtim!

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bashkia Shkodër me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert në bashkëpunim me Kongresi Rinor Kombëtar ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Rininë, dhe nëpërmjet këtij dokumenti prezanton përpjekjen e saj më serioze për të ndërhyrë thellë e në mënyrë gjithëpërfshirëse për transformimin e realitetit ku jetojnë, studiojnë dhe ëndërrojnë të rinjtë e qytetit.

Vizioni ynë për vitet e ardhshme projekton krijimin e kushteve dhe një mjedisi të sigurt social, shëndetësor dhe politik, për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës dhe me status të konsoliduar për të ardhmen e tyre. Prioritet do të jetë përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjes së plotë të të rinjve në shoqëri dhe vendimarrje.

Gjashtë shtyllat kryesore mbi të cilat bazohet SVR janë pjesë integrale e

“Strategjisë Europiane për të Rinjtë 2019-2027” dhe në koordinim të plotë me të gjithë dokumentat strategjike në nivel qendror dhe vendor. Në evindentimin e këtyre shtyllave rol të rëndësishëm patën analiza e situatës aktuale dhe analiza SWOT e të gjithë fushave që janë kompetencë e Bashkisë. Potencialet dhe problematikat e evidentuara janë ndërthurur dhe kombinuar duke formuluar këto objektiva:

Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës adreson mangësitë fizike dhe materiale, si edhe vështirësinë e aksesit në institucione edukuese, për shkak të aftësive, përkatësisë në një grup vulnerabël apo të marginalizuar etj. Ky prioritet përmbledh dhe adreson të gjitha nivelet e arsimit në territorin e Bashkisë Shkodër. Objektivat dhe masat për këtë prioritet janë ndërtuar duke marrë në konsideratë mundësitë ekzistuese për zgjidhjen e këtyre problematikave dhe, njëkohësisht, duke parashtruar masa që mund të ndërmerren drejt zgjidhjes.

Punësimi dhe sipërmarrja rinore përfshin dhe adreson papunësinë e të rinjve (duke përfshirë sidomos angazhimet sezonale ose studentore), efektshmërinë dhe zbatueshmërinë e politikave që janë në fuqi, vetëpërfshirjen e të rinjve dhe palëve të treta në organizata të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare e më tej.

Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimmarrje merret drejtpërdrejtë me përfaqësimin e të rinjve për të marrë pjesë në Këshillin Bashkiak si organ përfaqësues i Bashkisë, me mundësitë dhe motivimet e të rinjve dhe të rejave për të marrë pjesë drejtpërdrejtë në politikëbërje dhe vendimmarrje në Bashkinë Shkodër. Në këtë kontekst, për të arritur në konkretizimin e masave të sugjeruara, janë analizuar nisma të mëparshme dhe efektshmëria e tyre, si edhe janë marrë në konsideratë nisma ekzistuese.

Art, sport, kulture dhe mjedisi përfshin dhe adreson kohën e lirë, nevojën argëtim dhe promovimin e të rinjve virtuoze dhe të talentuar adreson cilësinë e jetës së shëndetshme dhe një qytet me ajër të pastër, nxitjen dhe zhvillimin e turizmit. Masat janë orientuar drejt krijimit të hapësirave, aktiviteteve, programeve, mundësive kulturore, hapësirave për të

ushtruar sportin, për të bërë art dhe aktivitete të tjera krijuese dhe argëtuese.

Mbështetja e organizatave dhe nismave rinore në qytetin e Shkodrës parashikon jo vetëm një përjasje mbështetëse nga ana e Bashkisë Shkodër, por edhe një ndërveprim aktiv, në mënyrë që të ketë sa më shumë nisma cilësore nga ana e të rinjve. Për këtë, prioritetet dhe masat janë orientuar drejt mundësive financiare dhe aktiviteteve konkrete që ndihmojnë organizatat grupimet dhe nismat rinore, në mënyrë që të funksionojnë si duhet dhe të kenë qëndrueshmëri.

Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe lehtësirash që të rinjtë përfitojnë për shkak të grupmoshës në të cilën ata bëjnë pjesë. Realizimi i këtyre shërbimeve dhe përfitimi që do të kenë të rinjtë, do të sillte përmirësimin e gjendjes dhe mirëqënies së tyre në qytet dhe, për rrjedhojë, mirëfunksionimin e tyre efektiv si qytetarë të kësaj Bashkie.

1.1 QËLLIMI

Dinamikat qeverisëse në Shqipëri po orientohen gjithnjë e më shumë drejt hartimit dhe zbatimit të politikave në nivel vendor, kjo në vazhden e decentralizimit të pushtetit qendror dhe mbështetjes së autonomisë së Njësive të Qeverisjes Vendore (NjQV) për përmbushjen e funksioneve të përcaktuara me ligj. Politikat dhe dokumentat strategjike sektoriale janë instrumenta të nevojshëm për të udhëhequr sektorë të veçantë, në përputhje të plotë me funksionet dhe kuadrin ligjor.

Qëllimi i këtij Plani Veprimi është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të nxisë zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik vendor. Në veçanti, pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit socioekonomik të saj përbëjnë një domosdoshmëri për arritjen e standardeve europiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t'u përballur me sfidat e globalizimit.

Plani Lokal i Veprimit frymëzohet nga vizioni european mbi angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve në Bashkinë Shkodër. Përparësitë e angazhimit strategjik synojnë

shfrytëzimin optimal të burimeve në dispozicion dhe një bashkërendim të punës jo vetëm ndërmjet strukturave të Bashkisë Shkodër që kontribuojnë në zhvillimin e rinisë por edhe bashkërendimin e punës së institucioneve në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në fokus do të jetë dhe krijimi i sinergjive nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile, organizatave ndërkombëtare dhe bizneseve.

Strategjia synon që të nxisë aktivizmin rinor dhe rritjen e kapaciteteve për të rinjtë në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi dhe hapësira në të ardhmen. Bazuar gjithashtu në qëllimin dhe objektivat e "Strategjisë Europiane për të Rinjtë 2019-2027", strategjia vendore për të rinjtë synon që të bashkojë të rinjtë për ndërtimin e një qyteti pa barriera, duke e kthyer kështu qytetin në një hapësirë të dedikuar për brezat e rinj.



1.2 METODOLOGJIA

Studimi është realizuar në nivel kombëtar dhe shtrirë në 12 Bashki në fokus, ku 10 prej tyre janë bashki qender qarku. Ai është konceptuar të realizohej në disa faza, të përcaktuara dhe detajuara në vijim. Realizues dhe Zbatues të studimit do të jenë KRK dhe rrjeti i organizatave nëpërmjet koordinimit dhe punës në terren nga 12 koordinatorët lokal.

Për çdo Bashki, do të jetë 1 koordinator lokal në bashkëpunim me subjektet pjesë e rrjetit të KRK, e cila është përgjegjëse për realizimin në terren të studimit dhe për përfshirjen e gjetjeve nga studimi në Planet Lokale të veprimit sipas secilës Bashki përkatësisht. Theksojmë se studimi është realizuar në të gjithë territorin në mbulim të Bashkisë respektive, pra duke konsideruar edhe ish-komunat, sot njësitë Administrative.

Studimi është i ndarë në këto faza:

1. Faza e parë është krijimi i backgroundit të Research Topic (Nevoja e hartimit të planeve lokale të veprimit për rininë). Kjo fazë përfshin:

- Hulumtimi në literaturën (Praktikat në Rajon dhe Rregullimet Ligjore përkatëse)
- Përcaktimi i metodologjisë së kërkimit
- Përcaktimi i kuadrit teorik (Legjitimimi i

kërkimit) dhe karakteri aplikativ i tij (përse na duhet? Dhe çfarë na sjell?)

2. Faza e dytë është mbledhja e të dhënave cilësore: të tipit të raporteve; të dhënave të publikuara për situatën e të rinjve në nivel vendor për 6 fushat e përcaktuara. Kjo fazë përfshin:

- Evidentimi i të gjitha problematikave që lidhen me informacionin/informimin e të rinjve për hapësirat/mundësitë reale të përfshirjes dhe angazhimit të tyre në 6 fushat prioritare të përcaktuara.
- Evidentimi i raportit buxhet i parashikuar-buxhet i shpenzuar për aktivitete dhe zbatimin e politikave rinore (Ballafaqimi i kërkesave/nevojave i Ri (e)-Pushtet Vendor).
- Përcaktimi i nevojave dhe prioriteteve komunitare e lokale sipas secilës fushë që Plani Lokal i Veprimit mendohet të përfshijë.
- Kapacitetet e pushtetit lokal dhe për përmbushjen e kërkesë-nevojave komunitare për të rinjtë.

3. Faza e tretë ka të bëjë me skicimin e Research Design-it nga secila Organizatë për secilën Bashki përkatësisht, sipas vendit ku ato operojnë:

- Formulimi i Hipotezës;
- Formulimi i Pyetjeve Kërkimore;
- Nxjerrja e Implikimeve;
- Nxjerrja e Indikatorëve/treguesve për Studimin.

4. Faza e katërt ka të bëjë me përcaktimin e të dhënave të tilla si:

- Lloji i kampionimit që do të përdoret/ si? Dhe ku? do të mbledhen të dhënat.
- Sa persona do të pyeten/madhësia e kampionimit në nivel kombëtar.
- Nga cilat grupmosha do të nis studimi.
- Sa persona do të pyeten për secilën bashki.
- Listimi i indikatorëve/ përkthimi i tyre në pyetje.
- Cilat alternativa nxjerrin më në pah problemin kërkimor (Mangësitë e konstatuara në nivel lokal specifikisht, evidentimi i nevojave, identifikimi i prioriteteve sipas objektivave strategjike për planet lokale të veprimit).

Kjo fazë është e përbërë nga këto etapa:

- Skicimi i Kampionimit - kjo do të bëhet secifikisht për secilën Bashki në program.
- Hartimi i pyetësorit - bazuar në indikatorët për 6 fushat prioritare për të rinjtë.
- Pre-testimi i Pyetësorit - (sa i kuptueshëm dhe i realizueshëm është për t'u arritur). Evidentimi dhe reflektimi i ndryshimeve/draftimi

final i pyetësorit.


5. Faza e pestë ka konsistuar në realizimin në terren të procesit të anketimit (2400 pyetësorë gjithsej) dhe mbledhja e të dhënave sasiore. Kjo fazë u zhvillua në 2 muaj, ku puna në terren me pyetësorët zgjati një javë të plotë dhe u angazhuan në terren 12 koordinatorët lokal me ndihmesë nga vullnetarë dhe asistues sipas nevojës.

6. Faza e gjashtë është checkimi i pyetësorëve dhe hedhja e të dhënave. Krijimi i një baze të plotë të dhënash në excel.

7. Faza e shtatë është përpunimi statistikor (frekuenca dhe crosstabe) i të dhënave në SPSS sipas implikimeve të përcaktuara në fazën e tretë.

8. Faza e fundit është përpilimi i raportit me gjetjet, përfundimet, dhe rekomandimet përkatëse.

9. Hartimi i Planeve Lokale të Veprimit për secilën Bashki, bazuar në procesin e mësipërm.



PARIMET UDHËHEQËSE

Parimet të cilat kanë udhëhequr procesin e hartimit të PLR-së, janë edhe parimet mbi të cilat Bashkia Shkodër synon të ndërtojë të ardhmen e qytetit me qytetarët. Më konkretisht këto parime konsistojnë në:

Zhvillimi i qëndrueshëm: Ky parim ka udhëhequr gjithë procesin e hartimit të PLVR-së dhe udhëheq njëherazi gjithë strategjitë kryesore kombëtare, rajonale dhe vendore. Pra është e rëndësishme që shfrytëzimi i burimeve të bëhet në mënyrë sa më të balancuar dhe nëpërmjet një planifikimi të integruar për të arritur zhvillim ekonomik dhe social që garanton qëndrueshmëri në kohë dhe jetëgjatësi. Ky parim është thelbësor kur flitet për të ardhmen e rinisë, motorrit kryesor të shoqërisë shqiptare.

Subsidiariteti: Plani është hartuar duke pasur parasysh që ushtrimi i përgjegjësisë publike duhet në mënyrë të përgjithshme, t'iu takojë më tepër autoriteteve të cilat janë më pranë qytetarëve ku dhe impakti është më i madh. Bashkia Shkodër që prej vitesh ka pasur në fokus të veçantë rininë nisë dhe nga fakti se zhvillimi dhe integrimi i të rinjve është cilësuar gjithmonë si guri i themelit të një shoqërie të fortë.

Bashkërendimi: Kjo strategji ka synuar të koordinohet me kuadrin strategjik të zhvillimit të Bashkisë Shkodër, duke ndjekur objektivat dhe parimet thelbësore të zhvillimit të përcaktuara në dokumentat strategjike vendore. Në të njëjtën

mënyrë, PLVR është përpjekur të jetë në harmoni me interesat e shoqërisë civile dhe organizimeve rinore duke promovuar forma të ndryshme bashkëqeverisjeje apo bashkëpunimi për një zhvillim të qëndrueshëm. Përpjekjet e organizuara të të gjithë niveleve qeverisëse të mbështetura edhe nga organizatat rinore do të fuqizojnë rolin e të rinjve në të gjitha fushat.

Llogaridhënia dhe Transparenca: Qëllimet dhe objektivat strategjike, të përcaktuara në këtë strategji janë përkthyer në projekte dhe aktivitete specifike të matshme nëpërmjet treguesve të performancës, duke i bërë këto objektiva lehtësisht të matshme dhe të monitorueshme.

Gjithëpërfshirja: Strategjia ka patur në fokus kryesor filozofinë e gjithëpërfshirjes sociale duke u përpjekur në trajtimin e problematikave kryesore të çdo grupi social, me një vëmendje të lartë ndaj grupeve të marginalizuara të shoqërisë. Kjo nënkupton, krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë të rinjtë e Bashkisë Shkodër duke i ndihmuar ata në arritjen e mirëqënies së përbashkët.

Fleksibiliteti: Duke marrë në konsideratë reformat e shumta që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit dhe ndryshimet thelbësore që kanë prekur funksionet dhe kompetencat e NJQV-ve, strategjia është hartuar në mënyrë të tillë që të lejojë hapësirat e nevojshme për t'iu përshtatur kontekstit politik ende në ndryshim e sipër. Kjo do të thotë se objektivat strategjike dhe projektet janë hartuar duke marrë parasysh disa skenarë zhvillimi për të arritur përmbushjen më optimale të tyre përgjatë kësaj periudhe tranzicioni.

BASHKËRENDIMI ME POLITIKAT VENDORE, KOMBËTARE DHE EUROPIANE

Vizioni i këtij dokumenti orientues e strategjik për tre vitet e ardhshme kërkon vendosjen e rinisë në fokus të jetës aktive të qytetit nëpërmjet mbështetjes së partneritetit dhe nxitjes së bashkëpunimit me të rinjtë e vendeve europiane. Në mënyrë që të realizohet ky vizion afat-mesëm, është parësore që të bashkërendohet me planet kombëtare afat-mesme dhe afat-gjata dhe të ketë koordinim më efikas me organizatat rinore dhe aktorët e tjerë të përfshirë në këtë proces.

Mungesa për një kohë të gjatë e kuadrit ligjor për rininë ka bërë që përfshirja e të rinjve në jetën publike, vendimmarrje politike dhe shërbimet e dedikuara për rininë të jenë në vullnetin e titullarëve të institucioneve publike. Mungesa e kuadrit ligjor ka bërë që edhe bashkëpunimi jo vetëm ndër-institucional por ndërmjet rrjetit të shoqërisë civile dhe organizatave rinore të jetë i pastrukturuar dhe nuk përfshin të gjitha aspektet ku përfshihet rinia. Prandaj gjatë procesit të hartimit të Planin Lokal të Veprimit të Rinisë 2020-2023 janë marrë në konsideratë objektivat e politikave dhe planeve kombëtare, rajonale dhe vendore për të krijuar një kuadër zhvillimor më koherent dhe të qëndrueshëm dhe sa më pranë standardeve të Bashkimit European (BE).

Në nivel ndërkombëtar:

>>> Strategjia e BE-së për Rininë, e cila advokon fuqishëm për “punën e të rinjve” një koncept holistik që shkon përtej punësimit dhe mbulon aspekte të ndryshme të zhvillimit personal të të rinjve. Siç është përcaktuar në Strategjinë e Rinisë të BE-së, ka të bëjë me “fuqizimin, emancipimin, përgjegjësinë dhe tolerancën...”.

>>> Strategjia Europa 2020 ka qëllim nxjerrjen e 20 milion njerëzve nga varfëria, luftën ndaj përjashtimit social dhe forcimin e punësimit. Iniciativat kryesore nën këtë strategji janë Platforma kundër Varfërisë dhe Përfshirjes Sociale dhe Axhenda për Aftësi të reja dhe Vende pune.

>>> Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020 është në thelb të Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen Sociale 2007-2016, e cila përcakton mekanizmat dhe strategjitë për përfshirje sociale gjatë ciklit të jetës së individëve si: fëmijët, individët në moshë pune, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet. Për më tepër, është mbështetur nga programi i Progresit, një instrument financiar që ka për qëllim zhvillimin e politikave në 5 fusha strategjike: punësimi, mbrojtja dhe përfshirja sociale, kushtet e punës, anti-diskriminimi dhe barazia gjinore.



Në nivel kombëtar:

>>> Programi i Qeverisë 2017-2021 Ky program në seksionin e rinisë, parashikon hartimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së jetës, rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, programe dhe projekte për nxitjen e punësimit, krijimin e një kuadri ligjor të qartë për rininë ku përcaktohen qartë kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisjes lidhur me përgjegjësitë që kanë ndaj të rinjve, si dhe forcimin e rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

>>> Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020 (SKZHI) përcakton një qasje të integruar për zhvillimin socio-ekonomik të vendit po ashtu dhe për integrimin në BE. Impakti që kjo strategji kërkon është në 3 këndvështrime: së pari, një zhvillim ekonomik më i madh përmes rritjes së tregut të punës, forcimit të arsimit – duke përfshirë arsimin dhe trajnimin profesional, vullnetarizmin dhe minimizimin e ekonomisë informale. Së dyti, ka qëllim shndërrimin e rritjes ekonomike në mirëqenie sociale, përmes investimit në shërbime publike që ndihmojnë përfshirjen, kohezionin dhe cilësinë e jetës. Aksi i tretë i strategjisë bazohet në fuqizimin e qeverisjes, demokracinë dhe parametrat e ligjit të së drejtës.

>>> Strategjia për Punësim dhe Aftësi 2013-2020 ka qëllim ndërtimin e një fuqie punëtore më të arsimuar dhe të aftë sipas nevojave të tregut të punës. Politikat prioritare të identifikuar janë: a) forcimi i mundësive të punësimit përmes politikave efektive të tregut të punës, ku ofrimi i sa më shumë mundësive për të

rinjtë është një prioritet; b) ofrimi i arsimit dhe trajnimit profesional cilësor dhe trajnimit të të rinjve dhe të rriturve; c) nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial; dhe d) forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.

>>> Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015-2020
– harton një plan për ndërtimin e një sistemi të mbrojtjes sociale ku individët fuqizohen dhe grupeve vulnerabel iu ofrohen oportunitete që i bëjnë ata më shumë autonomë shoqëruar kjo me mekanizmat parandalues dhe të ri-integrimit në shoqëri.

>>> Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020 – Ky plan ka për qëllim hartimin e politikave të tërthorta për integrimin e plotë të të rinjve në skemën e shëndetësisë, arsimit, punës sociale dhe pjesëmarrjes politike me qëllim që ata të bëhen anëtarë aktiv të shoqërisë në të gjitha aspektet. Ky plan veprimi është bazuar në 6 objektiva strategjik si: Nxitja e të rinjve dhe pjesëmarrja e tyre në proceset demokratike/vendimmarrje; Nxitja e punësimit të të rinjve përmes politikave efektive të tregut të punës; Shëndetësia; Sporti dhe Mjedisi; Arsimi i të rinjve; Mbrojtja sociale; Kultura dhe Vullnetarizmi.

>>> Plan Kombëtar Veprimi 2010-2015 për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve - Plani është bazuar në një qasje të plotë që targeton minoritetet me qëllim përfshirjen e tyre. Kështu, politikat variojnë nga shërbime bazike si shëndetësia, arsimi, punësimi dhe strehimi; në shërbime më të sofistikuara si mbrojtja e trashëgimisë kulturore.



MATRICA E BASHKËRENDIMIT ME DOKUMENTAT STRATEGJIKE NDËRKOMBËTARE, KOMBËTARE DHE VENDORE

OBJEKTIVAT E STRATEGJISË VENDORE PËR RININË

DOKUMENTET STRATEGJIKE	Arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës	Punësimi dhe sipërmarrja Rinore	Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimmarrje	Art, sport, culture dhe mjedisi	Mbështetja e organizatave dhe nismave Rinore	Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbime publike për të rinjtë
Strategjia e BE-së për Rininë						
Strategjia Europa 2020						
Strategjia e Përfshirjes Sociale BE 2015-2020						
Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020						
Programi i qeverise 2017 – 2021						
Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 - 2020						
Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2015 – 2020						
Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015 - 2020						
Plani Kombëtar Veprimi për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianë						
Ligji mbi "Barazinë gjinore në shoqëri"						

III. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE DHE PLANIFIKIMI

SITUATA AKTUALE - ARSIMI CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS

Në territorin e Bashkisë Shkodër ekzistojnë 90 shkolla dhe 2 konvikte të cilat administrohen nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit (28 shkolla në qytet dhe 62 në Njësitë Administrative). Numri relativ i nxënësve që përfitojnë nga ky shërbim është 17.200, nga ku 11.227 nxënës në shkollat e qytetit dhe 5.973 nxënës në Njësitë Administrative.

- Në qytetin e Shkodrës funksionojnë 27 shkolla dhe 2 konvikte në qytet.
- Në Njësinë Administrative Rrethina funksionojnë 9 shkolla me 1.749 nxënës, 838 vajza.
- Në Njësinë Administrative Gur i Zi funksionojnë 7 shkolla me 1012 nxënës, 530 vajza.
- Në Njësinë Administrative Postribë funksionojnë 10 shkolla me 1098 nxënës, 559 vajza.
- Në Njësinë Administrative Ana e Malit funksionojnë 6 shkolla me 399 nxënës, 188 vajza.
- Në Njësinë Administrative Bërdice funksionojnë 5 shkolla me 632 nxënës, 294 vajza.
- Në Njësinë Administrative Velipojë funksionojnë 6 shkolla me 562 nxënës, 273 vajza.
- Në Njësinë Administrative Dajç funksionojnë 6 shkolla me 267 nxënës, 124 vajza.
- Në Njësinë Administrative Shalë funksionojnë 5 shkolla me 136 nxënës, 63 vajza.
- Në Njësinë Administrative Shosh funksionojnë 3 shkolla me 24 nxënës, 14 vajza.
- Në Njësinë Administrative Pult funksionojnë 7 shkolla me 95 nxënës, 38 vajza.

Për administrimin dhe funksionimin e shkollave Bashkia Shkodër ka realizuar skemën e mbështetjes financiare për shërbimet e mirëmbajtjes:

- Materiale mbështetëse në shërbimin e nxënësve me konvikt
- Materiale mbështetëse kuzhinë
- Furnizime me ushqime
- Materiale kancelarie
- Materiale të ndryshme

- Materiale hidraulike
- Materiale për pastrim për ambientet
- Shërbim i ngrohjes me dru zjarri
- Shërbim i ngrohjes dhe gatimit me gaz të lëngshëm
- Shërbimi i ngrohjes dhe transportit me lëndë djegëse (naftë)
- Mirëmbajtjen e pajisjeve dhe orendi
- Mirëmbajtje e mjeteve të transportit
- Shërbim i energjisë elektrike
- Shërbim me ujë të pijshëm
- Shërbimi internetit
- Shërbimi postar
- Materiale të ndryshme mbështetëse (xham, bojra)
- Materiale elektrike
- Mirëmbajtjen e zakonshme të ndërtesave;
- Pajisje dhe orendi për arsimin
- Pajisje teknike operacionale
- Pajisje elektronike
- Sigurimin e ndërtesave
- Shërbime për dizinfektim.

Në shumë prej shkollave në Bashkinë Shkodër ekzistojnë laboratore të ndryshme për lëndët shkencore por të cilat kërkojnë rivitalizim shkaku që nuk përmbushin kriteret për ushtrimin e eksperimenteve të ndryshme. Kjo gjendje kërkon përditësim apo edhe krijim të hapësirave dhe të instrumenteve të cilat domosdoshmërisht ndikojnë pozitivisht në rritjen e cilësisë së arsimit.

Sistemi i ngrohjes në shkollat e Bashkisë Shkodër është në nivelin të mirë, është i nevojshëm mirëmbajtja dhe përmirësimi nga lënda drurore në sisteme më të avancuara ekologjike.

Bashkia Shkodër zhvillon aktivitete të brendshme për promovimin e identitetit dhe vlerave lokale dhe kombëtare dhe gjithashtu nxit, mbështet dhe financon aktivitetet kulturore, sportive dhe argëtuese për të rinjtë. Gjejmë për përmirësim nxitjen dhe krijimin e programeve të shkëmbimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nëpërmjet projekteve të ndryshme kombëtare dhe rajonale.

Përveç arsimit parauniversitar ekziston edhe universiteti “Luigj Gurakuqi” me Fakultetet: Fakulteti i Shkencave Shoqërore me katër departamente: Departamenti i Gjuhësisë, Departamenti i Letërsisë, Departamenti i Historisë, Departamenti i Gjeografisë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës me pesë departamente: Departamenti i Matematikës, Departamenti i Informatikës, Departamenti i Fizikës, Departamenti i Biologji – Kimisë, Departamenti i Infermierisë.

Fakulteti i Shkencave të Edukimit me katër departamente: Departamenti i Punës Sociale, Departamenti i Mësuesisë, Departamenti i

Edukimit Fizik e Sporteve, Departamenti i Arteve.

Fakulteti Ekonomik me tre departamente: Departamenti i Administrim – Biznesit, Departamenti i Financë – Kontabilitet,

Departamenti i Turizmit.

Fakulteti i Drejtësisë me tre departamente: Departamenti i të Drejtës Publike, Departamenti i të Drejtës Civile, Departamenti i të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane.

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me tre departamente: Departamenti i Anglistikës, Departamenti i Gjermanistikës, Departamenti i Romanistikës

ARSIMI CILËSOR DHE GJITHËPËRFSHIRËS			
OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
1. Garantimi i shërbimeve cilësore infrastrukturore gjithëpërfshirëse për zhvillim të procesit mësimor edukativ në kushte të përshtatshme në territorin administrativ të Bashkisë Shkodër.	1.1 Shërbime të mbështetura financiarisht dhe infrastruktura gjithëpërfshirëse të ristauruara. 1.2 Laboratore funksionale dhe të pajisura me teknologji moderne. 1.3 Biblioteka shkollore funksionale.	1.1 Përmirësim i infrastrukturave fizike dhe mbështetje financiare për shërbimet arsimore. 1.2 Përmirësim i kushteve në laboratorët shkencorë ekzistente dhe krijim i laboratorëve shkencorë në ato shkolla ku nuk ekzistojnë. 1.3 Përmirësim i kushteve nëpër bibliotekave shkollore dhe furnizim me libra të rinj.	
2. Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore gjithëpërfshirëse për zhvillim të procesit mësimor edukativ.	2.1 Mjedise dhe objekte të sigurta. 2.2 Infrastrukturë lehtësuese për të rinjtë me aftësi ndryshe.	2.1 Përmirësim i kushteve të fushave sportive dhe palestrave ekzistente. 2.2 Përmirësim dhe përshtatje e infrastrukturave për të rinjtë me aftësi ndryshe.	
3. Nxitja, promovimi dhe hartimi i programeve të edukimit jo-formal dhe garantimi i hapësirave të sigurta rinore për zhvillimin e tyre.	3.1 Hapësira të sigurta rinore për zhvillim të programeve të edukimit jo-formal. 3.2 Programe dhe aktivitete të realizuara për promovimin e të rinjve të talentuar në art, kulturë dhe sporte. 3.3 Bashkëpunime për shkëmbime në Erasmus+. 3.4 Trajnime të ndryshme mbi aftësimin profesional.	3.1 Realizim i aktiviteteve që nxisin dhe promovojnë talentet e reja në fushën e artit dhe kulturës nëpër shkolla. 3.2 Realizim i aktiviteteve dhe programeve që synojnë ndërgjegjësimin e të rinjve për investim dhe përmirësim të komunitetit me qëllim indirekt që të ulët nivelin e braktisjes së shkollës. 3.3 Krijimi i strategjisë për integrimin e të rinjve të komunitetit Rom në shkolla të ndryshme të qytetit.	

SITUATA AKTUALE -PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE

Punësimi është një nga problematikat më kryesore që përballen të rinjtë jo vetëm në Shkodër por në gjithë Shqipërinë.

Bashkia Shkodër duke qenë se është vend bregdetar dhe malor bënë që gjatë sezonit veror të hapë më shumë mundësi për punësim shkaku i nivelit të turizmit të lartë.

Zhvillimi i turizmit malor dhe detar ka bërë që sipërmarrjet të zhvillohen si në cilësi ashtu edhe në krijimtari si p.sh: hostele të ndryshme tradicionale, hotele me oferta të ndryshme, kulinari tradicionale, guida turistike natyrore, kulturore, përpunim i produkteve tradicionale lokale.

Bashkia Shkodër në portalin e saj ka krijuar platformën "Tregu i punës" në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimin. Qëllimi i platformës "Tregu i Punës Shkodër" është nxitja e punësimit dhe rivitalizimi i tregut të punës

nëpërmjet informimit dhe orientimit të qytetarëve drejt institucioneve shërbim-ofruese nga njëra anë, dhe lehtësisë së procesit të identifikimit dhe rekrutimit të punëmarrësve nga ana e punëdhënësve.

Në Bashkinë Shkodër është bërë traditë panairi i punës ku të rinjtë marrin pjesë dhe janë në kontakt direkt me punëdhënës me profile të ndryshme.

Nga ana tjetër evidentohen probleme të përputhjes së kurrikulave mësimore profesionale të cilat janë në papërputhshmëri me tregun.

Në Qendrën Rinore Atelie të Bashkisë Shkodër gjendet edhe inkubatori i biznesit ku janë në fazën parapërgatitore të inkubohen 2 biznese.

Mungon fond specifik për "Start-up" dhe gjithashtu mungon formim/orientim në idetë inovative të biznesit.

Limit tjetër që është bërë i dukshëm në vitet e fundit janë edhe personat e kthyer nga emigrimi të cilët hasin vështirësi në integrim në tregun e punës.

PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE

OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
1. Ofrim i shërbimeve informative mbi tregun e punës dhe mundësi të reja të punës në territorin e Bashkisë Shkodër. 2. Politika lehtësuese dhe mbështetëse për sipërmarrjet dhe sipërmarrësit e rinj; ngritja e mekanizmave për subvencionimin e të rinjve fermer. 3. Aftësim dhe orientim i të rinjve për tregun e punës. 4. Krijimin e mundësive të intership-eve në përputhje me legjislaturën për punësimin e të rinjve. 5. Përmirësimin dhe përditësimin e kurrikulave të Qendrave të Formimit Profesional me profesione të reja.	1) Shërbime inovative të promovuara; 1000 të rinj të ndërgjegjësuar mbi politikën fiskale, legjislaturën për punësim dhe kodin e punës; portalin rinor i përditësuar. 2) 5 "Start up" të mbështetura dhe 10 të rinj fermer të subvencionuar, të cilët përfitojnë nga lehtësirat administrative, këshillimi juridik, asistencë në sipërmarrje dhe inkubim pranë inkubatorit të biznesit 3) Programe të edukimit jo formal, trajnime dhe orientim në tregun e punës. Mbi 100 të rinj të përfshirë dhe 20 të kthyer nga emigracioni. 4) 5 të rinj në intership 6 muajor pranë Bashkisë Shkodër. 5) Komision i ngritur me përfaqësues nga: Zyra e Punës, Drejtoria e Formimit Profesional Shkodër, Bashkia Shkodër, ZVA, Universiteti "Luigj Gurakuqi"...; Draft i hartuar i kurrikulave në përputhje me nevojat e tregut të të ardhmes.	1.1. Ndërgjegjësimi i të rinjve mbi politikën fiskale, legjislaturën për punësim, Kodin e Punës. 1.2. Përmirësimi dhe përditësimi i platformës "Tregu i punës Shkodër". 1.3. Përditësimi aktiv i sektorit të punësimit pranë portalit rinor www.shkodrarinore.gov.al 1.4. Realizimi i panairit të punës. 2.1 Krijimi i lehtësirave administrative, këshillim juridik, këshillim financiar dhe tatimor, marketing, inkubim pranë "Atelie" etj. 2.2 Mbështetja e 5 "Start up" dhe subvencionimi i 10 të rinjve fermer. 3.1 Krijimi i programeve të ndryshme të edukimit jo-formal mbi punësimin në bashkëpunim me aktorë ndërkombëtarë për përditësimin dhe krijimin e bizneseve inovative. 3.2 Trajnime sipërmarrje të rinjve të kthyer nga emigracioni me qëllim integrimin në tregun e punës. 4.1 Intership 6 muajor, sipas legjislaturave në fuqi, pranë Bashkisë Shkodër. 5.1 Krijimi i Komisionit ndërinstitucional për hartimin e kurrikulave. 5.2 Përpunimin e kurrikulave aktuale të Formimit Profesional për të krijuar profesione që i përgjigjen nevojave të tregut të të ardhmes.	

PJESEMARRJA DHE PERFAQESIMI RINOR NE POLITIKE DHE VENDIMMARRJE LOKALE

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORE	AKTIVITETE	FINAN CIM
Angazhimi i te rinjve ne politikë ne Bashkinë Shkodër është i konsiderueshem duke u bazuar ne kerkime te ndryshme te realizuara nga OJF te ndryshme kombetare. Bashkia Shkodër ka vene ne dispozicion te gjitha mjetet e informimit te qytetarit dhe ndergjegjesimit te tij ne marrjen e informacionit. Te rinjte e Bashkisë Shkodër shprehin ne menyre te zbehur vullnetin per te qene pjesë e proceseve te politikëberjes dhe ne vendimmarrjet lokale. Ne Shkodër ekzistojne forumet rinore te partive politike por funksinimi i tyre është i mbyllur dhe realizojne aktivite ad hoc, te cilat nuk kanë asnjë lloj impakti ne permirësimin e politikave rinore te qytetit.	1. Garantimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit rinor në politikat lokale me anë të krijimit të Kongresit Rinor Lokal pranë Bashkisë Shkodër. 2. Fuqizimi i të rinjve me anë të edukimit jo-formal në pjesëmarrje dhe përfaqësim rinor në politikë dhe vendimmarrje lokale. 3. Ndergjegjesimi dhe nxitja e rinise per pjesëmarrje ne votime. 4. Ndergjegjesimi dhe nxitja e te rinjve per te njohur strukturat politikëberëse dhe vendimmarrëse lokale dhe qendrore.	1) Kongresi Rinor Lokal i ngritur me 60 të rinj nga mosha 16 - 29 vjeç të anëtarësuar: 80% të rinj, 20% OJF rinore dhe per rinine. Rregullore e hartuar. 2) 50 të rinj të përfshirë në Akademinë Politike dhe mbi 30 të rinj të përfshirë në “Në qytetin tonë vendosim edhe ne” 3) 200 të rinj të informuar mbi rëndësinë e votimit dhe pjesëmarrjes në politikë; 8 shkolla të mesme të përfshira në takimet informuese me drejtoritë e Bashkisë Shkodër dhe shërbimet e qeverisë qendrore.	1.1. Krijimi i Kongresit Rinor Lokal si entitet i pavarur por në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, Këshillin Bashkiak, Qendrën Rinore Publike, Këshillin Studentor dhe Parlamentin e Shkollave të Mesme për hartim dhe monitorim të implementimit të politikave rinore. 1.2. Hartimi i regullores së KRL. 4.1. Ngritja e akademisë politike për edukim të rinisë në politikëberje dhe në lidhshp. 4.2. Realizim i projektit “Në qytetin tonë vendosim edhe ne” 3.1 Fushatë informimi për rëndësinë e votimit dhe pjesëmarrjes në politikë; njohja me procedurat e votimit; njohja me legjislacionin mbi zgjedhjet; trajnimi i të rinjve në monitorim dhe vëzhgim 3.2 Realizimi i takimeve në mes nxënësve dhe studentëve me drejtoritë të ndryshme të Bashkisë Shkodër me qëllim shkëmbimi informacionesh dhe ideve inovative. 3.3 Takim i të rinjve me strukturat e shërbimeve të qeverisë qendrore dhe shkëmbimin e informacioneve dhe nevojave.	

ARTI, SPORTI, KULTURA DHE MJEDISI

SITUATA AKTUALE	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINAN CIM
Situata aktuale në Bashkinë Shkodër mbi Artin, Sportin, Kulturën dhe Mjedisin është në kushte të favorshme për promovimin e të rinjve dhe fuqizimin e tyre. Në Bashkinë Shkodër klubi Vllazina me kategori të ndryshme sportive, Galeria e Arteve, Kështjella Rozafa, Muzeu “Oso Kuka”, Muzeu i Kështjellës, Fototeka “Marubi”, Teatri “Migjeni” etj. Bashkia Shkodër organizon aktivitete për promovimin e të rinjve si nga ana sportive, po edhe ajo kulturore dhe artistike. Nga ana tjetër Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizata të ndryshme promovon turizmin malor si dhe detar duke i përfshirë edhe të rinjtë vullnetar. Bashkia Shkodër ka funksionale Qendrën Rinore Atelie ku punohet për edukimin jo-formal të të rinjve, promovimin e tyre dhe zhvillimin e tyre në aftësitë që dëshirojnë ti mprehin.	1. Rehabilitimi dhe organizimi i terreneve sportive/rikreative ekzistuese, hapësirave kulturore dhe artistike. 2. Promovim dhe mbështetje e të rinjve të talentuar në arte, sport dhe muzikë. 3. Promovimin e vullnetarizmit ndër të rinjtë e Bashkisë Shkodër si një ndër pikat kyqe të zhvillimit të komunitetit.	1) 5 terene sportive/rikreative të hapura në 5 lagjet e Bashkisë Shkodër me asistencën e OJF. 2) Numri i konkurseve kulturore, festivaleve kombëtare; Numri i aktiviteteve promovuese për të rinjtë e talentuar; Buxheti i venë në dispozicion për të gjitha aktivitetet promovuese, konkurset kulturore si dhe festivaleve kombëtare. 3) Numri i pjesëmarrësve, Numri i aktiviteteve të realizuara nga shkollat e mesme në “Ditën e Vullnetarizmit” 4) Numri i të rinjve pjesëmarrës në ditët e sensibilizimit pranë Qendrave Komunitare “Për Familjen”, numri i të rinjve nëpër grupet vullnetare të lagjeve.	1.1 Organizimi dhe hapja për përdorim të 5 terreneve sportive shkollore në 5 lagjet e Bashkisë Shkodër me asistencën e organizatave. 2.1 Realizim i aktiviteteve dhe konkurseve për arte pamore, kampionateve sportive në mesin e shkollave të mesme dhe konkursin e shkrimtarëve të rinj me qëllim nxitje të kreativitetit. 2.2 Hartimi 3 aktiviteteve nga të rinjtë mbi vlerat historike dhe kulturore të komunitetit të Shkodrës sidomos në zonat rurale. 2.3 Organizimi kampeve verore gjithëpërfshirëse. 2.4 2.4. Organizimi i vizitave kulturore për të rinjtë e zonave rurale në institucionet kulturore të Bashkisë Shkodër. 3.1 Realizimi i aktiviteteve sensibilizuese me nxënës të shkollave të mesme në Bashkinë Shkodër në “Ditën e Vullnetarizmit”. 3.2 Nxitje dhe sensibilizim në vullnetarizëm me të rinjtë e Bashkisë Shkodër pranë Qendrave Komunitare “Për Familje”. 3.3 Organizim i aktiviteteve vullnetare për lagje të ndryshme të Bashkisë Shkodër.	

SITUATA AKTUALE MBËSHTETJA E ORGANIZATAVE RINORE DHE NISMAVE RINORE

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e Bashkisë Shkodër është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurëse, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve shoqërore për shtresat në nevojë. Bashkia e Shkodrës ka nisur një iniciativë koordinimi me organizatat për të implementuar iniciativat të përbashkëta të shtrira në të gjithë territorin e saj. Nëpërmjet këtij hapi pozitiv, Bashkia ka ndërmarrë leadershipin për të koordinuar më mirë dhe me më tepër efektivitet burimet e disponueshme dhe në të njëjtën kohë për t'u siguruar se janë adresuar nevojat dhe prioritetet e komunitetit, duke shmangur njëkohësisht mbivendosjet. Procesi është akoma në vazhdimësi e sipër dhe synon hartimin e planeve të përbashkëta dhe ndarjen e përgjegjësisë në përpunime me objektivat strategjike dhe synimet kryesore. Bashkia Shkodër ka arritur në marrëveshje bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore, me qëllim ofrimin e shërbimeve në territorin e saj, përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit. Ndër shërbimet që ofrohen në bashkëpunim me organizatat janë; fuqizimi socio-ekonomik i familjeve në vështirësi ekonomike, shërbimet alternative të kujdestarisë familjare, mbështetja dhe integrimi i personave me aftësi ndryshe, deinstitutionalizimi, ri-integrimi i fëmijëve migrantë apo të rikthyer nga emigracioni, përfshirja sociale për romët dhe egjiptianët, si një shtysë e mirë për integrimin e këtij komuniteti, mbrojtja dhe trajtimi i viktimave të dhunës në familje, buxhetimi me pjesëmarrje dhe përfshirja e qasjes gjinore në buxhetin e Bashkisë së Shkodrës, promovimi i territorit të Bashkisë Shkodër, promovimin e produktit territorial etj. Për bashkëpunimin me shoqërinë civile, dhe koordinimin e këtij

bashkëpunimi, Bashkia Shkodër ka ngritur dhe ka vënë në funksion tryezën konsultative me shoqërinë civile. Kjo tryezë zhvillon një sërë takimesh brenda një viti, dhe synimi i kësaj tryeze është konsolidimi i bashkëpunimit, vlerësimi i nevojave të komunitetit, ofrimi i shërbimeve në përpunime me nevojat e territorit dhe ndarja e shërbimeve sipas nevojave.

Gjithashtu me qëllim realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, Bashkia Shkodër është shpallur fituese në thirrjen e lançuar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i projektit është që të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritetit në BE në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet fuqizimit të shoqërisë civile duke mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive në vendimmarrje si dhe nxitjen dhe krijimin e një mjedisi ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.

Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër merr përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projekti ReLOaD. Bashkëfinancimi është programuar i ndarë në dy vite buxhetore për periudhën e kohëzgjatjes së projektit 2018 – 2020.

Bashkia Shkodër angazhohet që gjatë periudhës kohore 2018 – 2020 të organizojë tre thirrje publike, nga të cilat, dy të parat do të financohen nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i Bashkisë) dhe thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë Bashkisë. Thirrjet për projekt propozime do të realizohen në zbatim të VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për "Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër" si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile". Në total fondi i vënë në dispozicion për OSHC-të është 123.000 \$.

Për vitin 2018 u realizua thirrja e parë për projekt propozime. Në këtë thirrje aplikuan 20 OSHC nga të cilat 3 u shpallen fitues. Në mbështetje të marrëveshjes financiare Prot nr. 331/30 datë 17/05/2018, kontributi i Bashkisë Shkodër ishte 1 831 022 lekë.

Për vitin 2019 u realizua thirrje e dytë për projekt propozime. Në këtë thirrje aplikuan 12 OSHC nga të cilat

3 u shpallen fitues. Në mbështetje të marrëveshjes financiare Prot nr. 1729/25, datë 17.06.2019, kontributi i Bashkisë Shkodër ishte 1 267 543 lekë.

Për vitin 2020, thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë Bashkisë.

MBËSHTETJA E ORGANIZATAVE RINORE DHE NISMAVE RINORE				
	OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
	1. Mbështetja, formimi dhe fuqizimi i të rinjve në ngritjen e organizatave. 2. Programe dhe politika nxitëse për mirëfunksionimin e organizatave.	1) Numri i trajnimeve dhe i pjesëmarrësve. 2) Numri i panairëve, numri i organizatave rinore, grupeve joformale, këshillave rinor pjesëmarrës. Buxheti në dispozicion i vendosur nga Bashkia. Numri i organizatave të vendosur në database.	1.1. Zhvillimi i trajnimeve mbi krijimin dhe menaxhim të organizatës. 1.2. Trajnime mbi shkrimin dhe menaxhimin e projekteve. 1.3. Garantimin e asistencës teknike të organizatës për formim të vazhdueshëm dhe mjediseve për zhvillimin e aktiviteteve. 2.1 Organizimi i panairëve të organizatave rinore, grupeve joformale rinore, këshillave rinor. 2.2 Organizim të shkëmbimeve rinore, mes të rinjve, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. 2.3 Krijimin e databasës së organizatave që operojnë në territorin e Bashkisë Shkodër në web faqen e Bashkisë Shkodër.	

SITUATA AKTUALE - ÇËSHTJET SOCIALE, SHËNDËTËSORE DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Shkodra sot është një nga qytetet në të cilin ndodhen e funksionojnë shumë institucione e qendra sociale në mbështetje të grupeve sociale në nevojë. Përveç qendrave e institucioneve publike dhe private, tradita e njohur bamirëse shkodrane ka krijuar një klimë nxitëse e pozitive për krijimin e shërbimeve të shumta, të reja e alternative nga organizatat jofitimprurëse vendase e të huaja, nga institucionet fetare dhe individë.

Nevojat e mëdha të shkaktuara nga tranzicioni i tejzgjatur dhe “klima” humanitare e qytetarëve tanë kanë krijuar një rrjet mbështetjeje, shërbimesh e përkujdesi për grupet

sociale më në rrezik.

Gjatë vitit 2016 filloi krijimi i rrjetit të shërbimit social në komunitet, u ngritën qendrat komunitare “Për familjen”, të cilat ofrojnë shërbime sociale si informim, orientim, këshillim, shërbim në familje, mbështetje psikosociale, etj. Këto qendra u ngritën në pesë lagje të qytetit dhe në njësinë administrative Dajç dhe Guri i zi, u ngrit Qendra Rinore Publike “Atelie”, Qendra Komunitare Multifunkionale “Për Familjen” që synon fuqizimin dhe integrimin e komunitetit rom dhe egjiptian.

Duke u mbështetur në shërbimet ekzistuese, eksperiencën e krijuar dhe nevojat sociale në komunitet, Bashkia e Shkodrës synon të mbështesë zhvillimin e integruar dhe të vazhdueshëm të mirëqenies sociale të familjes si qeliza bazë e komunitetit tonë të shtrirë në të gjithë territorin.

ÇËSHTJET SOCIALE, SHËNDËTËSORE DHE SHËRBIMET PUBLIKE

OBJEKTIVAT STRATEGJIK	INDIKATORË	AKTIVITETE	FINANCIM
1. Garantimi i marrjes së informacionit për mundësitë e ndryshme për rininë mbi ndërgjegjësimin në çështje shëndetësore dhe shërbime publike nga Bashkia Shkodër. 2. Fuqizimi i Qendrës Rinore Publike “Atelie” dhe Qendra Rinore Publike për nën Shkodrën dhe mbi Shkodrën. 3. Shërbime sociale për të rinjtë aftësi ndryshe, orientim të ndryshëm seksual, si dhe për të rinjtë nga grupet e disavantazhuara. 4. Zbritja e tarifës fiskale për studentët të pajisur me Kartë Studenti. 5. Aktivitete për 6. parandalimin e problematikave për të rinjtë: ekstremizmi, bullizmi, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, sëmundjet kronike, infektive, varësia ndaj drogave dhe alkoolit.	1) Materialet promocionale të printuara; numri i takimeve dhe pjesëmarrësve; frekuentimi i webfaqes; regjistrimi i të rinjve në databasë. 2) Plani Vjetor i Qendrës dhe organigrami së bashku me fishat e aktiviteteve; frekuentimi i portalit dhe rrjeteve sociale të Qendrës; hapja e dy filialeve të qendrës rinore Atelie në mbi Shkodër dhe nën Shkodër. Buxheti i vënë në dispozicion për të gjitha aktivitetet promovuese, konkurset kulturore si dhe festivaleve kombëtare. 3) Numri i të rinjve që përfitojnë shërbime në Qendrat Komunitare “Për Familjen” dhe paket e shërbimeve të ofruara. 4) Tarifa të zbritura në Paketën Fiskale të Bashkisë Shkodër dhe të miratuara nga Këshilli Bashkiak Shkodër. 5) Koalicioni ndërinstitutional, drafti i strategjisë parandaluese dhe edukuese, numri i fushatave sensibilizuese.	1.1. Organizimi i takimeve, fushatave të ndryshme informuese nga Bashkia Shkodër për çështjet shëndetësore, sociale, si dhe shërbimet publike; 1.2. Përditësimi i webfaqes www.shkodrarinore.gov.al mbi mundësitë e fundit për rininë. 1.3. Krijimi i databasës rinore. 2.1. Mirëmbajtja dhe organizimi i Qendrës Rinore Publike “Atelie”. 2.2. Ngritja e planit vjetor të punës së Qendrës Rinore Publike “Atelie”. 2.3. Mirëmbajtja dhe përditësimi i portalit rinor www.shkodrarinore.gov.al 2.4. Zgjerimi i hapësirave rinore të sigurta brenda hapësirave të shkollave të mesme në nën-Shkodër dhe mbi -Shkodër, filiale të Qendrës Rinore “Atelie” në rrjetin e strukturave të shërbimeve komunitare. 3.1 Përmirësimin e shërbimeve psiko-sociale për të rinjtë me aftësi ndryshe, orientim të ndryshëm seksual, si për të rinjtë e grupeve të disavantazhuara. 4.1 Zbritje të tarifave për studentët të pajisur me Kartë Studenti pranë të gjitha institucioneve në varësi të Bashkisë Shkodër. 5.1 Ngritja e koalicionit ndërinstitutional për hartimin e strategjisë parandaluese dhe edukuese mbi nevojat aktuale të të rinjve. 5.2 Fushata sensibilizuese nëpër shkollat e Bashkisë Shkodër.	

IV. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një metodë planifikimi e strukturuar që përdoret gjerësisht për të evidentuar dhe vlerësuar Pikat e Forta (Strengths), Pikat e Dobëta (Weaknesses), Mundësitë (Opportunities) dhe Rreziqet/ Sfidat (Threats) të një projekti, çështjeje, territori, etj.

Gjatë hartimit të këtij Plani Veprimi, kjo metodë u përzgjedh si një instrument mjaft praktik dhe i dobishëm për të analizuar situatën ekzistuese, analizë mbi bazën e të cilës u hartuan qëllimet dhe objektivat strategjike. Pikat e dobëta dhe Pikat e forta evidentojnë çështje shqetësuese të të rinjve brenda territorit të Bashkisë Dibër, të cilat mund të adresohen nëpërmjet politikave vendore, ndërsa Mundësitë dhe Sfidat i përkasin aspekteve të jashtme, kontrolli i të cilave mund të kërkojë bashkëpunim ndërvendor apo angazhim të qeverisë vendore e më gjerë.



MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SVR-së

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është të sigurohemi që plani po zbatohet sipas afateve dhe synimeve të caktuara dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e standardeve të përcaktuara me ato që po zbatohen në realitet. Monitorimi siguron mbledhjen sistematike të të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij plani për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm. Monitorimi dhe vlerësimi është një pjesë kritike e menaxhimit të mirë të programit dhe llogaridhënies. Përmes monitorimit, zbatuesit dhe aktorët

përgjegjës për këtë plan sigurohen që aktivitetet që kryhen janë në përputhje me ato të planifikuara dhe brenda afateve kohore të përcaktuara. Gjithashtu monitorimi parashikon edhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime si edhe bën të mundur parashikimin e vështirësive para se të shfaqen.

Aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit janë një komponent thelbësor për të përmirësuar efektivitetin e vetëqeverisjes vendore. Monitorimi dhe vlerësimi siguron informacion mbi zbatimin e objektivave dhe programeve, që i mundëson Bashkia Dibër të përfitojë nga sukseset dhe të mësojë nga eksperiencat e zbatimit.

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit kërkon përpjekje të përkushtuara, ekspertizë, aftësi, vlerësim dhe menaxhim të mirë. Ky proces konsiderohet si një nga më të rëndësishmit gjatë periudhës së zbatimit të një dokumenti strategjik, pasi shmang devijimet nga përmbushja e objektivave të SVR 2019- 2023. Me qëllim që të sigurohet monitorim dhe raportim cilësor dhe i dobishëm, është e nevojshme që të përcaktohet si më poshtë vijon:

- Procesi i qartë i raportimit dhe i monitorimit me përgjegjësitë dhe kalendarin;
- Modelet dhe instrumentet që do të përdoren për monitorimin;
- Kapaciteti i strukturave kryesore dhe pjesëmarrëse.

Procesi i qartë i monitorimit dhe raportimit është i nevojshëm për të informuar pjesëmarrësit për përgjegjësitë e tyre dhe për t'u mundësuar atyre që të përgatiten për të gjitha angazhimet duke u bazuar në një kalendar të përcaktuar më parë. Sistemi i monitorimit duhet të jetë i mirëorganizuar për të ndjekur të gjitha hallkat që të mbulohen të gjitha projektet dhe të përcaktohen dhe konfirmohen strukturat monitoruese.

Modelet dhe instrumentet janë të nevojshme për rrjetin e komunikimit mes strukturave dhe për të garantuar se paraqitja e informacionit është e pajtueshme dhe e lehtë për t'u konsoliduar. Udhëzimet se si të plotësohen modelet duhet të jenë të përgatitura në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Përveç modeleve për elementë si objektivat do të jenë të nevojshme edhe sqarimet, sidomos në rastet kur vërehen vonesa apo mangësi për të detajuar elementët që sjellin devijime serioze. Informacioni i prodhuar përmes sistemeve të monitorimit dhe të raportimit mund të përdoret brenda Bashkisë Dibër për të marrë vendime dhe jashtë saj për të siguruar transparencë për publikun e gjerë.

Kapaciteti i strukturave për të prodhuar informacion cilësor dhe për të konsoliduar informacionin është shumë i rëndësishëm. Duhet përpjekje dhe aftësi për të prodhuar informacion raportimi të mirë të bazuar në analiza dhe të mbështetur nga prova. Praktika në sektorin publik tregon se

shumë shpesh raportimi i informacionit fokusohet në veprimet e përditshme rutinore më shumë sesa në analizën e arritjeve. Kapaciteti mund të përmirësohet përmes udhëzimeve, trajnimit dhe praktikës.

Sistemi i monitorimit dhe i vlerësimit i propozuar përbëhet nga dy nivele:

I. Niveli i parë lidhet me monitorimin e projekteve duke ndjekur me vëmendje arritjen e indikatorëve të përcaktuar në këtë dokument. Ky proces do të realizohet nga strukturat përgjegjëse brenda dhe në varësi të Bashkisë Dibër. Raportet e monitorimit të këtyre strukturave do të dërgohen tek struktura përgjegjëse për vlerësimin dhe jetësimin e prioriteteve në Bashkisë Dibër. Periodiciteti i monitorimit është vendosur bazuar në specifikat që ka çdo projekt.

II. Niveli i dytë lidhet me vlerësimin e përmbushjes së objektivave dhe rezultateve të pritshme. Ky vlerësim do të realizohet çdo fund viti, ku nëpërmjet analizës së raporteve të monitorimit do të vlerësohet masa e përmbushjes së objektivave, krahasimi i masës së arritjeve me masën e parashikuar, si edhe në raste të veçanta do të propozohen edhe ndryshime në projekte, kohëzgjatje, afate, fonde etj.

Monitorimi i SVR-së është fazë shumë e rëndësishme dhe matësi më i mirë i suksesit në zbatueshmërinë e saj. Puna do të nisë bazuar në procedurat administrative për të siguruar raporte mbi zbatimin e projekteve të ndryshme. Pastaj, gradualisht do të përmirësojmë cilësinë e informacionit të krijuar gjatë procesit dhe përfundimisht ky informacion do të përdoret në sistemin e vendimmarrjes.

Bazuar në kalendarin e monitorimit të strategjisë çdo vit do të përgatiten vlerësimet e ecurisë së SVR-së dhe do të raportohet tek Kryetari lidhur me ecurinë e punës për përmbushjen e objektivave strategjike. Në varësi të ecurisë së punës mund të propozohen edhe rishikime të objektivave strategjike. Në varësi të specifikave që kanë monitorimi/raportimi i projekteve do të kryhet në periudha 3 – 6 mujore. Raportet do t'i dërgohen strukturës përgjegjëse sipas afateve të përcaktuara. Vëmendje të veçantë i është kushtuar indikatorëve si sinjalizues të ecurisë së punës.

